



ANALIZA VJETORE 2012

(Mbi veprimtarine e administrates se Bashkise për vitin 2012)

Janar 2013

Te nderuar pjese marrës !

Objekti i takimit të sotëm ka si qëllim, të analizojë në mënyrë të përgjithshme, realizimin e objektivave dhe treguesve kryesorë të vitit 2012 dhe të përcaktojë objektivat që do arrihen gjatë vitit 2013.

Viti 2012 ishte një vit i veçantë dhe mjaft i rëndësishëm, për faktin se populli ynë punoj me shumë pasion dhe gjithë shqiptarët, si ato brenda dhe jashtë kufirit shtetëror shqiptar, gezuan përvjetorin e madh e të rëndësishëm, 100 vjetorin e ngritjes së Flamurit Kombëtar, Shpalljes Pavarësisë dhe krijimit të shtetit Shqiptar.

Për të arritur në ditët e 28 nëntorit të vitit që sapo mbyllem në këtë mjaft punë, angazhim dhe vlerësim i situatës. U shpalosen vlera historike, kulturore, intelektuale dhe politike, nga gjithë shqiptarët, përfshirë edhe përfaqësuesit e komunitetit lezhjan.

E vlerësojmë vitin 2012 jo vetëm si një vit Jubilar, por edhe si një vit në të cilin u vertetuan mjaft premtime dhe objektiva, të cilët mundësuar të përmbyllem një vit festiv, një muaj fest dhe pritje të shqiptarëve nga të gjitha trevat e diasporës, që realizojnë një ditë perkujtimore me mjaft dinjitet për një popull të histori 100 vjeçarë të shtetit dhe Pavarësisë së tij.

Por, krahas anës festive dhe pritjeve protokollare, gjatë vitit 2012 u desh punë dhe organizim, për të përballuar ndikimet e gjithanshme të krizës ekonomike e cila jo pak ka lënë gjurmë edhe në financat e bashkisë tone.

Nëpërmes këtij raporti, diskutimeve dhe opinioneve tuaja, do të mundësohet plotësimi i kësaj analize dhe do vendosen piketat e punës për vitin që sapo kemi filluar.

Nënder problemet që do trajtojmë në këto analize janë:

- a. Realizimi i detyrave dhe objektivave të parashikura, për vitin 2012 në nivelin e drejtimit dhe organizimit në funksion të zhvillimeve ekonomike, hartimin dhe zbatimin e projekteve në infrastrukturën publike dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj komunitetit qytetar etj.
- b. Do japim disa nga treguesit kryesorë të arritur gjatë vitit 2012, me problematiken me të cilën është ndeshur administrata e Bashkisë gjatë vitit 2012 dhe mangësitë e vërejtura në punën e saj;
- c. Nëndersa në fund të kësaj analize do të njihemi me disa nga objektivat kryesorë të vitit 2013, të cilët do jenë pika referimi në punën gjithvjetore të administratës së bashkisë në bashkëpunim me përfaqësuesit e zgjedhur – Këshillin e Bashkisë.

Te nderuar pjese marrës:

Është viti i dytë i mandatit të 8 majit 2011, dhe i dyti mandat si Kryetar Bashkie.

Në kontekstin politik jam përpjekur që në gjithë praktiken time drejtuese dhe menaxhuese, të mbetem Kryetari i gjithë qytetarëve, pa dallime politike e shtresa sociale;

Në aspektin administrativ viti 2012 është shoqëruar me ndryshime relativisht të cilësore duke i dhënë komunitetit një administratë me të reformuar, me të re në moshe, e arsimit dhe e gatshme, për të përballuar sfidat e mijëvjeçarit të ri.

Në aspektin ekonomik, kam bërë të gjitha përpjekjet të vlerësoj situatën ekonomike globale, të shfrytëzoj mundësitë dhe burimet e të ardhurave vendore, njëkohësisht kam bërë të gjitha përpjekjet e duhura, për tërheqjen e fondeve publike nga ministratë dhe donator të tjerë vendas e të huaj.

Për **vitin 2012** që sapo kemi mbyllur e vërtetojmë këto tregues:

1. Të ardhurat vendore nga 205.673 mijë lekë të planifikuara për vitin 2012 u realizuan 104.082 mijë lekë, ose rreth 50.6 % e parashikimit.
2. Shpenzimet buxhetore u realizuan në shumën 171.333 mijë leke, ose 53.6 %.

Nënder të cilët:

- a. Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore u realizu 96.7 %;
- b. Shpenzimet për administratën dhe shërbimet 97 %;

- c. Sherbimet me kontrate u realizuan ne masen 96 perqind
 - d. Shpenzimet per kulturen u realizuan 100 perqind
 - e. Shpenzimet per arsimin u realizuan 100 perqind
3. Moren rruge ose u realizuan disa investime publike si :
- a. Ndertimi i plote i rruges Kalase dhe lidhja saj me rrugne e Spitalit;
 - b. Ndertimi i rruges dytesore te Spitalit;
 - c. Rikonstruksioni i Shkolles 9 vjeçare “Kosova”
 - d. Ndertimi i shkolles 9 vjeçare “Beslidhja”;
 - e. Ndertimi Gjimnazit te Ri;
- Si nje vit ne te cilin Bashkia mundesoj zgjidhje te rendesishme, per komunitetin, ne aspektin e permiresimit te infrastruktures publike si nepermes investime direkte nga grandit i Qeverise Shqiptare, nga te ardhurat vendore dhe nga nje praktike e Re si ajo e Kredise me Banken Raiffeisen;
 - Qe perballuam mjaft veshtiresi te lidhura me krizen ekonomike mbarëboterore, krize e cila ka lene mjaft pasoja dhe vazhdojne akoma te mbeten ndikimet e saj ne ekonomine shqiptare dhe ate te bashkise Lezhe.
 - Qe filluan investime me vlera te konsiderueshme dhe te pa realizuara ndonjehere ne qytetin tone, ne te gjitha lagjet e qytetit, te financuara nga grandit i qeverise, kredia e bankes dhe te ardhurave vendore, nder te cilat mund te permendim:
 - a. Ndertimi i rruges Kalase;
 - b. Ndertimi i rruges dytesore te Spitalit,
 - c. Ndertimi i rruges ne bllokun 11,2 ha lagje Beslidhja,
 - d. Ndertimin e shkolles mesme te qytetit;
 - e. Rikonstruksioni i lagjes Gurra,
 - f. Rikonstruksioni i lagjes Spitalit,
 - g. “ ” i lagjes “Nene Tereza”;
 - h. Sistemimin e bllokut ne bregun e lumit Drin - lagje “Beslidhja”.
 - i. Rikonstruksioni i rruges tek shkolla “Gj. Fishta”; etj.
 - Përfunduar hartimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit dhe jemi në fazën e përshtatshmerisë me ligjin e Ri “Per Planifikimin e Teritorit”;
 - U përmirësuan raportet e bashkëpunimit me donator të huaj, për financimin e projekteve në funksion të institucioneve arsimore dhe shërbimeve publike;
 - Realizuar shtimin e bimeve dekorative dhe përmirësimin e zonave të gjelbërta në blloqet e banimit dhe akseset e rrugëve të qytetit.
 - Qe morem nismen mjaft serioze, për reformimin e administratës së Bashkisë, nëpërmes konkurimit të vlerave dhe aftësive profesionale, për të krijuar një administratë cilësore, të kualifikuar dhe stabile ndaj ndryshimeve politike.
 - Qe moren jete projekte për kushtezimin e ndihmës ekonomike nëpërmes “Punës dhe shërbimeve në komunitet”, projektet sociale të perkujdesjes për moshën e tretë, për fëmijët Rom, familjet në nevojë etj.
 - U përmirësuan shërbimet ndaj komunitetit qytetar dhe atij të biznesit, me rritjen e gatishmerisë dhe cilësive të shërbimit nga Zyra për “Marrëdhënie me Publikun”, “Qendra Kombëtare e Rregjistrimit”(QKR-ja), shërbimi “Gjendjes civile”, zyra e “Prodhimit të pasaportave biometrike”, në sektorin e shërbimeve publike etj.
 - Janë evidentuar indikatorët e zhvillimit dhe jemi në fazën e perfundimit të rivlerësimit të “Strategjisë së Zhvillimit Afatmesen”, për periudhën 2012 - 2020.
 - Po krijohet një traditë e re në promovimin e vlerave kulturore, historike dhe arkeologjike të qytetit të Lezhës, për rritjen e interesit të vizitoreve vendas dhe të huaj, në funksion të zhvillimit të “Turizmit Kulturor”.

- U zhvilluan mjaft veprimtari kulturore, artistike dhe promovuese ne funksion te argetimit te qytetareve, ne pergjigje te kerkesave te intelektualeve, te grup moshave te ndryshme, etj.
- Krahas ruajtjes se tradites ne perkujtim te festave, ngarjeve historike e kulturore te qytetit, u arrit te riciklohen ata festa te reja si "Nata e Bardhe e Kultures Shqiptare", "Dita e Emigrantit" te cilat po behen pjese e kultures dhe tradites se re ne qytetin tone.
- Vemendje e veçante eshte kushtuar raporteve te partneritetit me Keshillin e Bashkise, konform detyrimeve ligjore, duke qene gjithnje koherent dhe cilesor ne vleresimin e kerkesave dhe detyrimeve ndaj tij si organ vendimmarres. Keshtu per vitin 2011 evidentohet nje bashkepunim mjaft frytdhenes, i cili prodhoj 100 vendime ne harkun kohor te një viti.

Cilat ishin disa nga drejtimet kryesore të punës ne administraten e Bashkise, për vitin 2012 dhe si janë realizuar ata ?!

Ne administraten e bashkise gjate vitit 2012 kane funksionuar 9 drejtori dhe 5 sektorë me nje administrate prej 65 veta, perfshire edhe funksionet e deleguara (Gjendja Civile & QKR-ja) dhe 6 institucione vartese.

Ne gjithte aktivitetin e vitit 2012 nga punonjesit e administrates dhe institucioneve vartese eshte punuar me objektiva konkrete afatshkurter dhe afatmesem, per te mundesuar realizimin e detyrave te vitit dhe per krijuar premiset, per nje pune ne vazhdimësi.

E vleresaur ne kete kendveshtrim, mund te evidentojme se gjate vitit 2012 kemi patur keto zhvillime::

DREJTORIA E TE ARDHURAVE :

Ka patur si mision :

1. Regjistrimin e vazhdueshem dhe menaxhimin e subjekteve të tatueshme, ndjekjen e politikave programore dhe strategjitë implementuese mbi licencimin e rrjetit të biznesit në qytetin e Lezhës ne veprimtarine gjithëvjete;
2. Perditësimin e database të të gjitha subjekteve tregtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Lezhës te regjistruara ne organet tatimore;
3. Ushtrimin e kontroleve efikase ne rrjetin e tregetisë se qytetit me objekt realizimin e te ardhurave fiskale, planifikuar per vitin 2012.

Cili ka qene realizimi i detyrave te vitit 2012 nga kjo drejtori :

Në zbatim te ligjit "Për sistemin e taksave vendore" dhe vendimin e Keshillit Bashkise "Për miratimin e nivelit të taksave e tarifave vendore të vitit 2012" ne punen e drejtorise se te "Ardhurave Vendore" ka dominuar tendenca, per bashkepunim te vazhdueshem me komunitetin e biznesit, per realizimin e te ardhurave te buxhetit te planifikuar per vitin buxhetor.

Jane ushtruar funksionet në llogaritjen, faturimin dhe arkëtimin e zërave të ndryshëm të të ardhurave nga taksat dhe tarifate vendore për vitin 2012

Duke analizuar treguesit e realizimit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2012, krahasuar kjo me planin e vitit 2012, por dhe me të njëjtën periudhë të një viti më parë kemi këto shifra si më poshtë.

Në total, nga 205673 mijë lekë të ardhura të planifikuara për Bashkinë Lezhë nga taksat dhe tarifate vendore vitin 2012, janë realizuar të ardhura gjithsejt në shumën e 104082 mijë lekë, ose mbi 50.6%% e planit. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi arkëtuar më pak të ardhura në shumën e 37479 mijë lekë, ose 27% më pak të ardhura.

A.Nga 123900 mijë lekë të ardhura të planifikuara nga taksat për vitin 2012, janë realizuar të ardhura nga taksat në shumën e 53045 mijë lekë, ose rreth 42.8% e planit vjetor. Krahasuar me

të njëjtën periudhë të një viti më parë kemi arkëtuar më pak të ardhura nga taksat në shumën e 62676 mijë lekë, ose 54% më pak se viti 2011. Por ku janë më të theksuara këto diferenca apo mosrealizime, i analizojmë me radhë zërat e të ardhurave nga taksat :

Të ardhurat tatimore

1. Taksa mbi pasurinë (taksa mbi ndërtesat),

Nga 13000 mijë lekë të ardhura të planifikuara për t'u arkëtuar për vitin 2012, për zërin e “**taksës mbi pasurinë, taksa mbi ndërtesat**”, janë arkëtuar të ardhura në shumën e 6.844 mijë lekë, ose 53% e planit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë arkëtuar më shumë të ardhura në masën e 1.677 mijë lekë. Taksa mbi pasurine aplikohet për abonentët familjarë dhe për biznesin.

- Nga 5.822 mijë lekë të planifikuara për t'u arkëtuar për “**taksën e pasurisë për biznesin**”, janë arkëtuar të ardhura në masën e rreth 5.673 mijë lekë, ose rreth 97.4% e planit. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë vitit kaluar, janë arkëtuar më shumë të ardhura në masën e **922** mijë lekë.
- Nga 7177 mijë lekë të planifikuara për t'u arkëtuar për “**taksën e pasurisë për abonentët familjarë**”, janë arkëtuar të ardhura në masën e 1171 mijë lekë, ose 16.3% e planit. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë, janë arkëtuar më shumë të ardhura në masën e 755 mijë lekë, ose 2,8 herë më shumë se një vit më parë.

2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë mbi ndërtimet e reja,

Nga 69000 mijë lekë të ardhura të planifikuara për t'u arkëtuar për vitin 2012, për zërin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, janë arkëtuar të ardhura në shumën e rreth 18505 mijë lekë, ose rreth 26.8% e planit. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë, janë arkëtuar më pak të ardhura në masën 52073 mijë lekë, ose 74 % më pak se një vit më parë.

3. Taksa mbi biznesin e vogël,

Nga 30521 mijë lekë të ardhura të planifikuara për t'u arkëtuar për vitin 2012, për zërin e taksës mbi biznesin e vogël, janë arkëtuar të ardhura në shumën e rreth 18199 mijë lekë, ose 59.6% e planit. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë, janë arkëtuar më pak të ardhura në masën e 10429mijë lekë, ose 36% më pak se një vit më parë.

4. Taksa e tabelës (taksa e tabelës dhe e reklamës),

Nga 3770 mijë lekë të planifikuara për t'u arkëtuar për vitin 2012, për zërin e taksës së tabelës dhe të reklamës, janë arkëtuar të ardhura në shumën e rreth 1594 mijë lekë, ose rreth 42% e planit. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë, janë arkëtuar më shumë të ardhura në masën e rreth 1054 mijë lekë më shumë, ose rreth 3 herë më shumë të ardhura se një vit më parë.

5. Taksa e fjetjes në hotel

Nga 150mijë lekë të ardhura të planifikuara për t'u arkëtuar për vitin 2012, për zërin e taksës së fjetjes në hotel, nuk janë arkëtuar të ardhura nga ky zë i taksave.

6. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluejtëshme,

Nga 6500 mijë lekë të ardhura të planifikuara për t'u arkëtuar për vitin 2012, për zërin e taksës së kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluejtëshme, janë arkëtura të ardhura në shumën e 7605 mijë lekë, ose rreth 17% më shumë se plani.

7. Taksa për zënien e hapësirave publike,

Nga 489 mijë lekë të ardhura të planifikuara për t'u arkëtuar për vitin 2012, për zërin e taksës për zënien e hapësirave publike, janë arkëtuar të ardhura në shumën e rreth 298 mijë lekë, ose rreth 61% e planit. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë, janë arkëtuar më pak të ardhura në masën e 204 mijë lekë.

8. Taksat e përkohshme (taksa për vendosjen e tavolinave për baret në hapësira publike, si rrugë dhe trotuare),

Nga 405 mijë lekë të ardhura të planifikuara për t'u arkëtuar për vitin 2012, për zërin e taksave të përkohshme, nuk janë arkëtuar të ardhura nga ky zë i taksave.

B.Nga 81773 mijë lekë të ardhura të planifikuara për vitin 2012, nga aplikimi i tarifave vendore, si rezultat i ofrimit të shërbimeve ndaj komunitetit të biznesit dhe atij qytetar, por dhe nga

përdorimi i aseteve të Bashkisë Lezhë, janë realizuar të ardhura në masën e **51036 mijë lekë**, ose **rreth 62% e planit**. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar **kemi arkëtuar më shumë të ardhura nga tarifat në shumën e rreth 25197 mijë lekë, ose rreth dy herë më shumë se një vit më parë**. Për të verifikuar se ku janë më të theksuara këto diferenca apo tejkalime, i analizojmë me radhë zërat e të ardhurave nga tarifat e shërbimeve, që hyjnë në ardhurat jotatimore :

Të ardhurat jotatimore

1. Nga tarifat e shërbimeve publike, nga 22757 mijë lekë të planifikuara për t'u arkëtuar për vitin 2012, janë arkëtuar të ardhura në masën e 12167 mijë lekë, ose 53% e planit. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë arkëtuar më shumë të ardhura në masën e 1663 mijë lekë, ose rreth 16% më shumë se një vit më parë.

a. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave urbane

Nga 19667 mijë lekë të ardhura të planifikuara për t'u arkëtuar për vitin 2012, për zërin e tarifës për pastrimin dhe largimin e mbetjeve urbane, janë arkëtuar 10503 mijë lekë të ardhura, ose 54% e planit, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë arkëtuar më shumë të ardhura në masën e 3114 mijë lekë, ose 42% më shumë se e njëta periudhë e një viti më parë.

Tarifa e pastrimit, konform paketës fiskale të bashkisë lezhë, aplikohet për biznesin e vogël, biznesin e madh, abonentët familjarë dhe institucionet. Kështu :

- o nga 3717 mijë lekë të ardhura të planifikuara për abonentët **“biznesi i vogël” si tarifa shërbimi**, janë arkëtuar të ardhura në masën e 3259 mijë lekë, ose 87% e planit, ose rreth 993 mijë lekë më shumë se e njëta periudhë e një viti më parë.
- o nga rreth 5350 mijë lekë të ardhura të planifikuara për abonentët **“biznesi i madh” si tarifë pastrimi**, janë arkëtuar të ardhura në masën e 5495 mijë lekë, ose rreth 3% më shumë se plani, ose 758 mijë lekë më shumë se e njëta periudhë e një viti më parë.
- o nga rreth 10500 mijë lekë të ardhura të planifikuara për abonentët **“familjarë” për tarifën e pastrimit**, janë arkëtuar të ardhura në masën e 1683 mijë lekë, ose rreth 16% e planit, ose 1339 mijë lekë më shumë se e njëta periudhë e një viti më parë.
- o nga 100 mijë lekë të ardhura të planifikuara për abonentët **“institucione publike” për tarifën e pastrimit**, janë arkëtuar të ardhura në masën e 66 mijë lekë, ose rreth 66% e planit, ose 1.6 here më shumë se një vit më parë..

b. Nga përdorimi i pronave publike, dhënia me qera e objekteve

Nga 2200 mijë lekë të ardhura të planifikuara për t'u arkëtuar për vitin 2012, për zërin e tarifave për përdorimin e pronave publike nga të tretët, janë realizuar të ardhura në shumën e rreth 1261 mijë lekë, ose 57% e planit. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë arkëtuar më pak të ardhura në masën e 1260 mijë lekë.

c. Nga dhënia e lejeve licencave,

Nga 900 mijë lekë të ardhura të planifikuara për t'u arkëtuar për vitin 2012, për zërin e tarifave për dhënie të lejeve e licencave, janë realizuar të ardhura në shumën e 422 mijë lekë, ose 47 % e planit. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë arkëtuar më pak të ardhura në masën e 191 mijë lekë.

2. Të ardhura të tjera

a. Në zërin **“nga veprimtaritë ekonomike”**, nuk kemi planifikuar të ardhura dhe nuk kemi arkëtuar të ardhura.

b. në zërin **“shitja e pasurive kapitale”**, janë planifikuar të ardhura në masën e 1.800 mijë lekë dhe nuk janë arkëtuar të ardhura.

c. në zërin **“qera mbi trojet, ndërtesat”**, janë planifikuar të ardhura në masën e 3000 mijë lekë, nga të cilat janë arkëtuar të ardhura në masën e 2250 mijë lekë, ose 75% e planit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë arkëtuar më shumë të ardhura në masën e rreth 900 mijë lekë.

d. në zërin **“kontribute dhe sponsorizime”**, janë planifikuar të ardhura në masën e 22394 mijë lekë, nga të cilat janë arkëtuar të ardhura në masën e 13557 mijë lekë, ose 60% e planit.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë arkëtuar më shumë të ardhura në masën e 13557 mijë lekë.

e. në zërin “**të ardhura nga gjobat**” janë planifikua të ardhura në masën e 2500 mijë lekë, nga të cilat janë arkëtuar të ardhura në masën e 609 mijë lekë, ose rreth 24% e planit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë arkëtuar më shumë të ardhura në masën e rreth 65 mijë lekë.

f. në zërin “**të ardhura të tjera**”, nga 22812 mijë lekë të planifikuara për t’u arkëtuar për vitin 2012, janë arkëtuar të ardhura në masën e 16502 mijë lekë, ose rreth 73% e planit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë arkëtuar më shumë të ardhura në masën e rreth 9218 mijë lekë.

Në zërin të ardhura të tjera përfshihen :

- o të ardhura nga “**tarifa e parkimit**”, e planifikuar në masën e 2860mijë lekë për vitin 2012, janë arkëtuar të ardhura në masën e 1565 mijë lekë, ose 55% e planit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë arkëtuar më shumë të ardhura në masën e 513 mijë lekë.
- o të ardhura nga “**shitja e biletave të memorialit**”, e planifikuar në masën e 160 mijë lekë për vitin, nga të cilat janë arkëtuar të ardhura në masën e 706 mijë lekë, ose rreth 4 herë më shumë se plani.
- o të ardhura nga “**shitja e biletave të stadiumit Besëlidhja**”, e planifikuar në masën e 200 mijë lekë për vitn 2012, nga të cilat janë arkëtuar të ardhura në masën e 40 mijë lekë, ose 20% e planit.
- o të ardhura nga “**tarifa per sherbimet administrative**”, e planifikuar në masën e rreth 260 mijë lekë për vitn 2012, nga të cilat janë arkëtuar të ardhura në masën e rreth 416 mijë lekë, ose 160 % e planit.
- o të ardhura nga “**tarifa e gjelbërimit dhe ndriçimit**”, të planifikuara për vitn 2012 në masën e 1967mijë lekë, nga të cilat janë arkëtuar të ardhura në masën e 1882 mijë lekë, ose 96%.

3.Të ardhura të tjera nga institucionet në vartësi

a.Në zërin “**pagesat e prindërve për çerdhet**”, të planifikuara në masën e 1200 mijë lekë për vitn 2012, nga të cilat janë arkëtuar të ardhura në masën e 1272 mijë lekë, ose 106% e planit. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë arkëtuar më shumë të ardhura në masën e rreth 119 mijë lekë.

b. Në zërin “**pagesat e prindërve për kopështet**”, të planifikuara në masën e 4000 mijë lekë për vitin 2012, nga të cilat janë arkëtuar të ardhura në masën e 4387mijë lekë, ose 110 % e planit. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë arkëtuar më shumë të ardhura në masën e 542 mijë lekë.

c. Në zërin “**pagesat e nxen.te shkollave te mesme**”, të planifikuara në masën e 100 mijë lekë për vitin 2012, nga të cilat janë arkëtuar të ardhura në masën e 290 mijë lekë, ose rreth 2.4 here më shumë se plani. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë arkëtuar më shumë të ardhura në masën e 204 mijë lekë.

Në total, nga 205573 mijë lekë të ardhura të planifikuara për Bashkinë Lezhë nga taksat dhe tarifat vendore për vitn 2012, janë realizuar të ardhura gjithsejt në shumën e 104082 mijë lekë, ose 51% e planit. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi arkëtuar më pak të ardhura në shumën e 37478 mijë lekë, ose 26% më pak të ardhura.

Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, bazuar në planet e te ardhurave te citit 2012, janë kryer të gjithë procedurat ligjore sa i përket llogaritjes së detyrimeve dhe shpërndarjes së fletë-njoftimeve e faturimeve për të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin brenda juridiksionit të Bashkisë Lezhë.

Gjatë këtij viti vemendja e Drejtorisë Rajonale të Taksave për vënien në eficencë të përdorimit të kasave nga subjektet e biznesit të vogël ka qenë shumë e ulët, për të mos thënë fare. Kontrollat bëhen vetëm për të verifikuar nëse subjekti është i pajisur me kasën fiskale apo jo, kurse sa i përket përdorimit të kësaj kase nga subjekti, kontrolli ka qenë në nivele shumë të ulëta. Janë këto

arsyet kryesore të rënies së nivelit të xhiros e rrjedhimisht dhe të rënies së arkëtimeve për taksën vendore mbi biznesin e vogël.

Brenda vitit 2012 janë regjistruar në filialin e QKR-së, në qytetin tonë, 116 subjekte të reja, ndërkohë që kanë mbyllur apo pezulluar aktivitetin e tyre 90 subjekte. Lista e subjekteve informale në qytet po shkurtohet dita ditës, nga 120 subjekte informale vetëm brenda zonës së qytetit deri tani janë 68 subjekte.

Ka përfunduar procesi i shpërndarjes së fletënjoftimeve për detyrimet për abonentët qytetarë (konform paketës fiskale afati i shlyerjes së detyrimeve për abonentët qytetarë është brenda 6 mujorit të parë të vitit në vijim). Megjithatë procesi i mbledhjes së detyrimeve nga kjo kategori taksapaguesish rezulton në nivele shumë të mira deri tani, pasi nga 423 kryefamiljarë, që kane derdhur detyrimet e tyre për taksat dhe tarifatat vendore ndaj bashkisë Lezhë për vitin 2011, për vitin janë arkëtuar të ardhura nga kjo kategori për 1304 familje, ose 3 herë më shumë se një vit më parë.

Në analizën e të ardhurave jotatimore, pamvarësisht mosrealizimit të planit, konstatohet rritje të zerave të vecantë, krahasuar kjo me të ardhurat e realizuara për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kështu në total të ardhura jotatimore, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë kemi realizuar 25197 mijë lekë më shumë të ardhura ose 2 herë më shumë se një vit më parë.

Një ndër arsyet kryesore të përqindjes së ulët të realizimit të planit për vitin 2012 në rendisim faktin, që ndryshe nga shumë vite të tjera, pamvarësisht mundësive reale për të mbledhur taksat, plani i të ardhurave është thuajse i barabartë me kapacitetin fiskal, ndaj dhe diferencat e mosrealizimeve janë shumë të mëdha. Diferencat më të mëdha në i kemi në mos realizimin e të ardhurave nga abonentët familjarë për taksën mbi ndërtesën dhe për tarifatat e shërbimeve publike që i ofrojmë kësaj kategorie taksapaguese. Megjithë shpërndarjen e njoftimeve zyrtare që DTTV ka kryer si detyrim ligjor të saj, ishte vetëm përdorimi i sanksioneve ai që bëri të mundur arkëtimin e të ardhurave të siguruara gjatë kësaj periudhe, duke mos kryer asnjë shërbim ndaj tyre pa likujduar taksat dhe tarifatat vendore.

DREJTORIA E FINANCES :

Ka patur si objektiv kryesor :

1. Ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të gjendjes financiare dhe ushtrimin e kompetencave në zbatim të efektivitetit ekonomik dhe drejtimit financiar.
2. Hartimin e treguesve të buxhetit, miratimin në keshillin e Bashkisë dhe ndjekjen e realizimit të tij, për vitin buxhetor.
3. Ushtrimin e kompetencave në zbatimin e parimeve të efektivitetit ekonomik dhe drejtimit financiar, për të ruajtur të balancuar të ardhurat me shpenzimet administrative.
4. Ndjekjen në mënyrë permanente të situatës ekonomike dhe prezantimi i nevojave, për ndryshime të mundshme në buxhetin e vitit, për të ruajtur ekuilibrat financiar të Bashkisë. etj.

Cilët janë disa nga treguesit financiar kryesor të vitit 2012 :

Drejtoria e **Finances**, për vitin e kaluar e ka përqendruar punën e saj në realizimin e treguesve të buxhetit të Bashkisë; si në mbledhjen e të ardhurave të parashikuara, ashtu edhe në financimin e shpenzimeve dhe investimeve të kryera, në përputhje me objektivat dhe dhe strategjinë e zhvillimit.

Megjithë perpjekjet dhe përmirësimet që janë bërë, duhet theksuar se plotësimi i gjithë zotimeve e objektivave për këtë vit, u kushtezuan nga;

- Mosplotësimi i të ardhurave sipas parashikimit;

Ne total, nga 205673 mijë lekë të ardhura të planifikuara për Bashkinë Lezhë nga taksat dhe tarifatat vendore vitin 2012, janë realizuar të ardhura gjithsej në shumën e 104082 mijë lekë, ose mbi 50.6% e planit. Krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi arkëtuar më pak të ardhura në shumën e 37479 mijë lekë, ose 27% më pak.

- Mos levrimit e plote te grandit te pashkushtezuar per kete vit;

Nga 64 465 nije leke e planifikuar, Ministria e Financave ka çelur 45 825 mije leke, ose 19 640 mije leke me pak. Kjo diference, me akt normativ, ka kaluar per energjise elektrike te Sh.a. Ujsjelles Kanalizime.

- Niveli i ulet i disbursimit te kredise se miratuar

Edhe per vitin e kaluar, Ministria e Financave miratoj te disbursoj ne llogariner tone vetem 8.2 milion leke, nga shuma e kredise miratuar prej 120 milion leke.

Kjo ka shkaktuar shume probleme, si ne shlyerjen e detyrimeve ngaj operateve ekonomik per investimet e kryera.

Megjithese ne nje vit te veshtire financiar dhe me aftesi paguse jo shume te mire, aparati i Bashkise, eshte perpjekur te administroj sa me mire fondet ne dispocion, konforme buxhetit te miratuar nga Keshilli i Bashkise.

Shpenzimet buxhetore u realizuan ne shumen 171.333.180.97 leke nga 319.426.000 leke te planifikuara, ose 53.6 perqind.

Fondi i pagave per punonjesit e aparatit Bashkise dhe institucioneve vartese, nga 69 734 000 leke te planifikuar, eshte realizuar 67 403 370 leke,ose 96.7 perqind. Gjate vitit kaluar ka gjetur zbatim vendim marrja e keshillit per struktura organizative, numeri i punonjeseve dhe niveli i pagave te punonjeseve. Fondi i vecant i krijuar ne masen 5 perqind te fondit te pagave, eshte perdore vetem per shperblimet e punonjeseve ne fund te vitit, ose 40 perqind e shumes se krijuar.

Shpenzimet operative dhe sherbimet me kontrarte realizohen ne masen 96 perqind, Nga keto; shpenzimet per administraten dhe sherbimet 97 perqind; per kulturen 100 perqind, ne arsimin 100 perqind, çerdhe 93 perqind etj. Ndonese financimi i tyre eshte bere nga 50 deri ne 60 perqind, per mungese te aftesise paguse.

Ne buxhetin e vitit kaluar jane parashikuar investime ne rritje, si me burime te vete Bashkise, ashtu edhe me fonde e financime te tjera nga shteti dhe donatore te ndryshem. Fondet e investimeve, me burime te brendshme te Bashkise, ishin te planifikuar 109 milion e 963 mije leke. Gjate vitit jane prokuruar mbi 90 perqind te objekteve dhe ne disa prej tyre si; Trotuari tek Ura e Cenit, Parkimi ne lagjen Gurra, Zyra me nje ndalese ne Bashki, Ndertimi i murit rrethus te shkollave te qytetit, etj., kane perfunduar punimet. Nderkohe, jane financuar objekte te parashikuar me fonde te ketij viti, te mbartur nga viti i kaluar si si edhe disa objeteve te ketij viti. Eshte firmosur kontrata me donatorin - Banka Raiffeisen-, per financimin e ndertimit te Kendit te Lojrave per femije dhe keto dite pritet ndertimi i tij.

Rikonstruksioni i Shkolles Kosova ka perfunduar dhe fale bashkepunimit me donatore Italiane, eshte vene ne shfrytzim nga shtatori i ketij viti. Perfundoj edhe rikonstruksioni i shkolles” Gj. Kastrioti “ me fonde te ministrise perkatese. Me ndertimin e murit rrethues, kompleksi i shkollave do ti pergjigjet gjithenje e me mire nevojave qe ka ky sektor i rendesishem.

Per vtin 2013 do perqendromi ne keto drejtime;

Do te bejme gjithe perpjekjet per levrimit e shumes kredise se miratuar, per te mbeshtetur perfundimin e objekteve te filluar me kredi.

- Do vazhdojme te mire administrojme fondet e krijuara. Shpenzimet operative do te kontrollohen me nivelin e realizimit te te ardhurave.

DREJTORIA E URBANISTIKES :

Ka patur si objektiv :

1. Organizimin e punës per mbylljen e procedurave administrative, per miratimin e Planit te Pergjithshem Rregullues të qytetit;

2. Zbatimin e ligjislacionit të urbanistikes, për ndertimet e reja dhe rikonstruksionet në institucione e qytetit, infrastrukturën publike dhe sektorin privat, .
3. Realizimin e strategjise së zhvillimit urban dhe menaxhimit të territorit të qytetit.
4. Hartimin e projekteve të zhvillimit, për infrastrukturën publike dhe ndjekja e planit të investimeve, për ndertimet e reja dhe rikonstruksionet në infrastrukture.

Nder realizimet e vitit 2012 në këte drejtori evidentojme :

1. Kane përfunduar të gjitha fazat teknike të Planit Përgjithshëm Rregullës të qytetit dhe është miratuar në KRRT-ne e Bashkise;
2. Janë ndjekur në të gjitha fazat e tyre, investimet në infrastrukturën dhe institucionet publike si ndertime të reja dhe rikonstruksione.
3. Miratimin e plote të emertimit të rrugeve dhe shesheve, në zbatim të reformës së ndërmarrë nga Qeveria shqiptare, për hartimin e një sistemi funksional dhe modern të adresave dhe referencave gjeografike në qytete.

a. Në aspektin projektimit dhe investimeve publike:

Është synuar në hartimin e studimeve urbanistike dhe projektet e zbatimit për infrastrukturën publike në bashkëpunim me njësinë e Prokurimit Publik, për prokurimin dhe zbatimin e këtyre projekteve. Kështu u arritën të përgatiten projekte mjaft cilësore, hartuar nga studio serioze të vendit, të cilët kanë krijuar mundësinë e prokurimit në 12 objekte të rëndësishme në infrastrukturën publike duke përfshirë të gjitha lagjet e qytetit, investime të cilat po realizohen me financime buxhetore, nga kredia me Raiffeisen Bank dhe nga të ardhurat e Bashkise.

b. Nder detyrat funksionale të kësaj drejtorie evidentojme :

1. Ka funksionuar KRRT-ja e Bashkise deri me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 10 119 datë 23.4.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, në të cilin janë miratuar Plani i Përgjithshëm Rregullues, pesë projekte publike dhe disa objekte private.
2. Janë ushtruar dhe mbajtur akte - kontrolli për të gjitha objektet (e pajisura me leje ndërtimi) që janë në ndërtim e sipër, sipas fazave të ndërtimit.
3. Nga sektori i Kadastres Urbane janë përgatitë dosjet për regjistrimin e 80 pronave 60 prej të cilëve janë rregjistruar dhe janë në proces për t’u dërguar në Ryren e Rregjistrimit edhe 200 praktika të tjera.
4. Të ardhurat nga ky sektor janë realizuar në masën 26,8 %, por me një vlerë prej 18.506.000 .

Krahasuar/ vite	Të ardhura		%
	Planifikuar	Realizuar	
2010	61 milion	59 573 878	97,7 %
2011	78 milion	70 578 064	90,48 %
2012	69 milion	18,506,000	26,8 %

Një aspekt i rëndësishëm në punën gjithëvjetore të kësaj drejtorie ka qenë dhe mbetet partneriteti me investitorët privat, krijimin e hapësirave ligjore, për paraqitjen e dokumentacionit teknik të objekteve private e dhenja e përgjigjeve në afatin që përcakton ligjit Nr. 10119 datë 23.4.2009 “Për Planifikimin e Territorit”.

Në përvijën e specialistëve të kësaj drejtorie janë krijuar raporte të drejta bashkëpunimi me investitorët privat si dhe janë ndjekur të gjitha fazat e ndërtimit të objekteve që nga përkrahimi deri në dërgimin e lejes së shfrytëzimit.

Aktualisht duhet vlerësuar fakti se hapësirat për ndertime të reja në Lezhë nga viti në vit kanë ardhur duke u zvogeluar. Ky fakt kushtëzon ndërprenjen e plote të ndertimeve të reja deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, për planifikimin e territorit dhe miratimin e Planit Rregullues, mjaft detyra specifike e presin stafin e urbanistikes me emertimin e ri që merr nga ligji si staf i “Planifikimit vendor të Territorit”, në vitin 2012.

DREJTORIA E NDIHMES EKONOMIKE & PERKUJDESIT SHOQEROR

Ka patur si objektiv :

1. Hartimin e projekteve publike me veprim afatshkurter & afatmesëm, për zbutjen e varfërisë, ndihmen ndaj familjeve ne nevojë dhe integrimin e pakicave mbeshtetur ne Strategjine Kombëtare.
2. Evidentimin e familjeve ne nevojë dhe personave me aftësi të kufizuar; brenda territorit të bashkisë, per t'u krijuar mundesite e favorshme dhe ofruar ndihmën e nevojshme ekonomike e shërbimin e duhur social brenda kuadrit ligjor.
3. Bashkëpunimin me shoqata, fondacione dhe sektore homolog, për hartimin e programeve te përbashketa ne ndihme te individeve dhe familjeve ne nevojë, per zbutjen e varferise.
Ne kete drejtori funksionojne dy sektore si :
 - a. Sektori i Ndiemes Ekonomike dhe
 - b. Sektori i Pekujdesit dhe Sherbimit Shoqeror.

SEKTORI I NDIHMES EKONOMIKE:

Vëmendje e veçantë i është kushtuar punës me dokumentacionin e përfituesve të Ndihmës Ekonomike dhe seleksionimit të kujdesshëm për familjet që futen për herë të parë në skemën e Ndihmës Ekonomike. Si rezultat i kësaj pune të kujdesshme, skema e Ndihmës Ekonomike me gjithë kërkesat e shumta këtë vit - është në ulje dhe konkretisht , nëqoftëse në vitin 2011 janë trajtuar mesatarisht në muaj 554 familje, këtë vit mesatarja mujore është 546.

Pra janë 8 familje më pak se viti i kaluar.

Përveç plotësimit të dokumentacionit të fillimit të vitit dhe atyre mujore, janë dërguar listat për konfirmim të gjitha institucioneve, projektet për në Këshillin e Bashkisë për miratim si dhe evidencat mujore, 2- mujore dhe të fondit (2 herë në vit) për në DRSHS Lezhë- brenda afatit ligjor.

Gjatë vitit 2012:

- Janë verifikuar në terren familjet që trajtohen me Ndihmë dhe janë intervistuar në zyrë gjithsej **596** familje.
- Në bashkëpunim me Instiucionet detyruese sipas VKM Nr. 787 dt. 14. 12. 2005 pika 14-15, si dhe nga verifikimi i bërë janë larguar nga skema e Ndihmës Ekonomike **109 familje** ku shkaqet më të shumta të këtyre largimeve kanë qenë: punësimi dhe vetëpunësimi i anëtarëve të familjeve, pjesëtar në emigracion, mosplotësim dokumentacioni etj.
- Janë futur në skemën e Ndihmës Ekonomike **90 familje** nga të cilat 47 familje të reja, ku numrin më të madh e zënë ato te ardhura me transferim nga zonat tjera, kurorët e reja , dalja nga Pagesa e Papunësisë, vajzat-nana etj.
Dukuri për t'u theksuar është se ka ndryshuar struktura e familjes që trajtohet me Ndihmë Ekonomike dhe konkretisht:

Struktura e familjes/ frymë	Gjithsej
Familje me 1 frymë	40
Me 2 frymë	74
Me 3 frymë	102
Me 4 frymë	147
Me 5 frymë	116
Me 6 frymë	41
Mbi 6 frymë	24

Gjithashtu duam të nënvizojmë se në skemën e Ndihmës Ekonomike, kryefamiljaret gra kanë një tendencë rritje nga viti në vit dhe aktualisht janë 114 gra ose 21 % e numrit të familjeve që trajtohen gjithsej. Mbi 50% të tyre janë të divorcuara, të tjerat janë të veja, vajza-nëna , jetime etj. Pjesmarrja në projekt e familjeve të planifikuara është realizuar në masën 90%. Volumi i punës sipas parashikimit është realizuar në masën 79 %. Mendojmë që për vitin 2013 në bashkëpunim

me Drejtorinë e Shërbimeve Publike të Bashkisë Lezhë të shohim mundësinë e shtrirjes së shërmimeve në komunitet edhe në lagjet periferike.

SEKTORI I PERKUJDESIT SHOQEROR:

Realizimi i detyrave dhe objektivave në këtë sektor është bërë në mënyrë sistematike e të kujdesshme çdo ditë e muaj duke shënuar arritje dhe performance në disa drejtime.

- Jane hartuar rregullisht grafiket e rikomisjonimit të dosjeve si dhe plotësimi i tyre me dokumentacionin e nevojshëm.
- Evidencat statistikore janë plotësuar e dorëzuar sipas treguesve të kërkuar me saktësi dhe në afatet e duhura.
- Kalkulimi i pagave është bërë çdo muaj dhe në vecanti dhënia e diferencave të pagave në nivelet e ndryshuara me akte ligjore gjatë periudhës.
- Gjate gjithë periudhës janë evidentuar problemet që kanë persona të paafte e invalid si dhe është asistuar për zgjidhjen e tyre konform ligjit.
- Gjatë këtij viti janë rikomisjonuar dosjet e të verbërve të pakomisjonuar që prej vitit 2002, ka mbetur vetëm një dosje të cilën po e presim nga KMPV-ja.
- Për këtë vit shqetësim i vazhdueshëm ka qenë mungesa e fondeve të akorduara nga Shërbimi Social Shtetëror. Rrjedhojë e kësaj kanë mbetur pa u realizuar pagesat e muajve Nëntor dhe Dhjetor për të gjithë të paaftët (Handikapët, të Verbërit, Paraplegjikët dhe Tetraplegjikët, Kujdestarët respektiv) dhe konkretisht për muajin Nëntor 494 persona me një fond prej 5 766 925 Lekë , për muajin Dhjetor 496 persona me një fond prej 5 603 800 Lekë. Për Invalidët e Punës , për muajin Tetor kanë mbetur pa u paguar 79 persona me një fond prej 234 700 Lekë; për muajin Nëntor 481 persona me një fond prej 1 503 500 Lekë dhe për muajin Dhjetor 486 persona me një fond prej 1 487 000 Lekë.
Shqetësimin e mësipërm e kemi bërë prezent disa herë me shkresa, pa përmendur këtu edhe komunikimet verbale me DRSHS-Lezhë.
- Mbështetur në V.K.M. Nr. 404 dt. 20. 06. 2012 “ Për përcaktimin e masës , të kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar nga personat me statusin e të verbërit dhe Invalidit, Paraplegjik e Tetraplegjik për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse” personat e përfshirë në vendimin e mësipërm nuk janë kompensuar për mungesë fondesh.

Në mënyrë të përmbledhur po paraqesim disa prej treguesve të realizuar për vitin 2012.

Treguesit për vitin 2012 në sektorin e PAK-se

Nr.	Emertimi	Viti 2012/ persona	Diferenca me vitin 2011
1	Te paafte	273	+ 27
*	Kujd.per te paaftet	46	+ 3
2	Para e tetraplegjik	40	+ 6
*	Kujd.per paraplegjik	40	+ 6
3	Te verber	59	+ 1
*	Kujd.per te verber	23	- 3
4	Invalidë pune	465	+ 15
	TOTALI	946	

Sipas pagesës në % kanë përfituar :

- Me 100 % = 361 persona
- Me 150% = 2 persona
- Me 200 % =8 persona
- Me 300 % = 11 persona
- Invalid të plotë = 391 persona
- Invalid të pjesshëm = 90 persona

B. SHERBIMET SHOQERORE

Ky Sektor, gjatë këtij viti ka punuar në përmirësimin e shërbimeve sociale ekzistuese nën varësinë e Bashkisë si dhe në ngritjen e shërbimeve të reja. Praktika e punës tonë është mbështetur kryesisht në bashkëpunimet me organizata e shoqata brenda dhe jashtë qytetit të Lezhës që kanë në fokus përmirësimin e jetës sociale e ekonomike të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë.

Referuar **Qendrës së Moshës së Tretë** puna jonë është përqendruar në ndjekjen e mbarëvajtjes, frekuentimit nga të moshuarit si dhe realizimit të veprimtarive të parashikuara.

Vështirësi në aktivitetin e kësaj qendre kemi patur në fund të muajit Maj kur përfundoi edhe projekti 1-vjecar i Kryqit të Kuq Spanjoll. Falë këtij projekti cdo muaj për 1 vit ofrohen edhe pako ushqimore për 10 të moshuar të vetmuar të cilët gjenden në kushte shumë të dobëta ekonomike.

Po në bashkëpunim me Kryqin e Kuq - Dega Lezhë vazhdojmë **kurset e rrobaqepësisë për vajza dhe gra në nevojë**.

Kemi ndjekur gjithashtu ecurinë e aktiviteteve në **Qendrën e Zhvillimit Ditor**. Për t'u vlerësuar është rritja e numrit të fëmijëve dhe të rinjve që po frekuentojnë këtë qendër, kjo vjen si rezultat i një pune të mirë të bërë në terren nga stafi i qendrës. Risi për këtë qendër ka qenë edhe ofrimi i shërbimit të fizioterapisë **falas** nga "Angeli Fizioterapi" duke i dhënë kështu një imazh më të mirë edhe shërbimeve që marrin fëmijët në këtë qendër.

Në bashkëpunim me **shoqatat rome** në Lezhë kemi bërë një përafrim dhe identifikim të familjeve Rome të Bashkisë tonë. Është bërë një punë relativisht e mirë duke marrë parasysh se vështirësitë e këtij "studimi" nuk mund të mbështeten në vetë-deklarim dhe në kritere të mirëpërcaktuara. Janë gjithsej 83 familje romë në Lezhë.

Një ndihmesë konkrete na ka dhënë edhe **Karitasi i Lezhës** në strehimin në apartamente te 5 familjeve në nevojë- kryesisht të atyre familjeve që jetonin në baraket që u prishën pranë Gjimnazit për shkak të zgjerimit të rrugës.

Këtë vit rëndësi i dhamë edhe fushatës sensibilizuese në kuadrin e **Ditëve Ndërkombëtare të Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave**. Kështu në bashkëpunim me forumet politike të grave , organizatat dhe gra nga Shoqëria Civile këtë vit kemi realizuar një marshim të mirë-organizuar në intinerarin më të populluar të rrugëve të qytetit.

Pritja dhe sqarimi i qytetarëve ka zënë vend kryesor në veprimtarinë tonë. Ka patur gjithsej 321 kërkesa, nga këto 168 për Ndihmë Ekonomike dhe 153 për Ndihmë Financiare, ku më të shumtat janë për shpërblim për raste festash, rikonstruksion banesash dhe pagesën e qerave.

DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE:

Ka patur si objektiva kryesore :

1. Rritjen e cilesise se sherbimit ndaj qytetareve ne të gjitha llojet e shërbimeve publike, të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin sistemit të pastrimit të qytetit, ruajtjes dhe pasurimit të fondit të gjelbërt në qytet dhe kurorën përreth tij, për një qytet të pastër dhe gjithmonë të gjelbëruar;
2. Bashkërendimin e punës me faktorë të tjerë të interesuar në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike dhe përfshirjes së banorëve në monitorimin vlerësimin dhe bashkëqeverisjen komunitare, për implementimin e suksesshem të projektit të grumbullimit e trajtimit të diferencuar të mbetjeve urbane.
3. Vlerësimin si detyrë permanente; mirëmbajtjen e institucionet publike, rrjetin rrugor, sistemin e kanalizimeve, sinjalistikën rrugore, rrjetin e ndriçimit publik;

Realizimi i pergjegjesive nga kjo drejtori:

Synimi kesaj drejtorie ka qene dhe mbetet rritja e cilesise se sherbimeve ndaj komunitetit, permiresimin e infrastruktures ne pergjithesi , ne funksion te rritjes se cilesise se jetes se qytetareve tane .Gjate gjithë veprimtarise tone eshte punuar me objektivin qe rezultatet ne te gjithë sektoret e sherbimeve te shenojne rritje .

Suksesi i punes tone ka qene perkushtimi ne pune i gjithe stafit te drejtorise , por edhe bashkepunimi mes sektoreve te sherbime dhe me drejtorit e institucionit .

Fal perkushtimit por edhe ndergjegjesimit te gjithe stafit per te kuptuar se drejtoria e sherbimeve publike ne gjithe veprimtarine saj eshte kontakti i pare me qytetarin per sherbimet qe Bashkia ofron ,mendoj se gjate vitit 2012 puna jone per rritjen e cilesise se sherbimeve ndaj qytetareve ka patur tendence ne rritje .

I-Sherbimet publike qe mbulohe me siper marrje :

a-Sherbimi i pastrimit te rrugeve ,trotuareve dhe shesheve si dhe grumbullimi e menagjimi i mbetjeve urbane .

Harta e sherbimit te pastrimit perfshin pothuajse te gjithe rruget , trotuaret dhe sheshet qe kane infrastrukture te pershtateshme per kete qellim , kjo siperfaqe eshte rreth 104000 m2 dhe vlera e kontrates eshte rreth 25 miljon leke te reja .

Jane aktualisht gjithesej rreth 80 pika per grumbullimin e mbetjeve urbane dhe me perfundimin e investimit ne bllokun 11,2 ha , ne lagjen “Nene Tereza” ,si dhe disa rrugeve ne te cilat investimi eshte ne prag te perfundimit apo sa eshte perfunduar, numri i pikave te grumbullimit do te shkoje ne 100 sipas nje plani te pregatitur per kete qellim. Gjithashtu kemi rreth 170 kontejnere qe sherbejne per grumbullimin e mbetjeve urbane .

Gjate vitit 2012 ka patur rritje te cilesise se ketij sherbimi jo vetem ne qender te qytetit ,jo vetem Brenda unazes se vjeter por ne te gjith siperfaqen qe mbulohet me kete sherbim . Duhet theksuar se rritja e nivelit dhe cilesise se ketij sherbimi eshte rezultat jo vetem i punes se siper marrjes qe mbulon kete sherbim ,por jane sere faktoresh qe kane ndikuar .

-Faktor kryesor mendoj eshte sensibilizimi i opinjonit publik per te dhene sejcili kontributin e tij per krijimin e nje mjedisi te paster dhe te shendetshem i cili eshte realizuar fale aktiviteteve te shumta te realizuara nga ana jone me nxenesit e shkollave , me parlamentin rinore me OJF te ndryshme etj , ku ne cdo aktivitet kane qene te pranishme mediat lokale .

Si cdo vit tjeter nga ana jone jane kryer anketime lidhur me nivelin dhe cilesine e sherbimeve te ofruara nga Bashkia , edhe kete vit per te marre opinjonin e qytetareve mbi cilesine e sherbimeve eshte bashkepunuar me (URI) Institutin e kerkimeve urbane .

-Ndarja e zonave te sherbimit

Zgjerimi i territorit administrativ i Bashkisë së Lezhës ka bere qe qyteti te ndahet ne 3 Zona, ku dhe cilesia e sherbimeve eshte e ndryshme,

Zona A perfshin qytetin ne, kufijte ligjor origjinalë administrative. Lagjet me kryesore te kesaj zone jane “Beselidhja” dhe rreth 50 % e lagjes “Skenderbej” ne kete zone sherbimi i pastrimit dhe grumbullimit te mbetjeve urbane shtrihet ne 90% te teritorit , kjo edhe per shkak te infrastruktures se pershtateshme .

Zona B, lagjet kryesore te kesaj zone jane “Gurrat”, “Spitali”, 50 % e lagjes “Skenderbej” si dhe “SMT”-ja ku sherbimi i pastrimit kryhet afersisht ne gjysmen e teritorit ndersa grumbullimi i mbetjeve ne 70-80% te teritorit te zones, kjo per shkak te mungeses se infrastruktures se pershtateshme .

Zona C lagje kryesore e kesaj zone është lagje “Nene Tereza” dhe “Sheher” ku mbulohet me sherbimin e pastrimit dhe grumbullimit te mbetjeve rreth 20 % e siperfaqes..

Krahas punes per rritjen e cilesise se sherbimit nga siper marrja perkatese, grumbullimi i mbetjeve urbane ne menyre te diferencuar kalimi nga sistemi me 4 rryma ne sistemin me 2 rryma e ka bere me te lehte ndarjen e mbetjeve ne kontejneret perkates duke ndikuar ndjeshem ne krijimin e nje mjedisi te paster dhe te shendetshem dhe rritjen e cilesine e jetes se qytetareve .

Masat qe do te merren per rritjen e cilesise se ketij sherbimi ne te ardhmen .

1-Per te rritur cilesine e sherbimit te pastrimit do te zbatajme me cdo kusht te gjitha pikat e kontrates ku rreth 60% e siperfaqeve te rrugeve do te fshihen me autofshese .

2-Do te zgjerohet harta e projektit te grumbullimit te mbetjeve urbane ne menyre te diferencuar gradualisht ne te gjith qytetin .

b-Sherbimi i gjelbrimit :

Ky sherbim kryhet ne nje siperfaqe te gjelbert prej 90561 m2, krahas sherbimeve ne siperfaqet e barit natyral dhe barit te kultivuar (lulishteve) , i sherbehet gjith bimesise dekorative ne teritorin e qytetit . Duhet theksuar se gjate ketyre viteve eshte punuar jo vetem ne shtimin e siperfaqeve te gjelberta por edhe ne shtimin dhe permiresimin e bimesise dekorative ne te gjith teritorin e qytetit .

Krahasuar me vitin 2008 ku siperfaqet e gjelberta ne qytetin tone ishin 76668 m2 , sot kemi rreth 15000m2 ose 15% me shume siperfaqe te gjelberta si rezultat i perfshirjes se gjith hapësirave te gjelberta te shkollave te qytetit per mirembajtje por edhe kthimi i disa siperfaqeve inerte ne siperfaqe te gjelberta .

Ne qytetin tone eshte permiresuar ndjeshem bimesia dekorative kryesisht druret dekorativ ,sot ne qytetin tone kemi pothuajse nga te gjith llojet e drureve dekorativ cilesore duke filluar me palmen me afro 50 drure te tille te cilet jane mbjellur ne qender te qytetit , nga semaforet ,para obiliskut deri tek berberet ,gjithashtu ne rrugen “Luigj Gurakuqi” kemi 165 drure dekorativ te llojit bli etj.

-Objektivat dhe prioritetet tona ne te ardhmen, Permiresimi i bimesise dekorative ne te gjith qytetin dhe venjen ne eficence sistemi e vaditjes ne te gjith siperfaqet e gjelberta te qytetit.

c- Sherbimi i dekorit .

Ne pergjithesi ky sherbim eshte kryer mire nga siperparrja perkatese ne te gjitha rastet festive dhe aktivitetet e zhvilluara ne qytetin tone . Viti 2012 ka qene nje vit i vecante ku dekori ne qytetin tone ka qene i pranishem vazhdimisht pasi ishte viti i 100 vjetorit te pavaresise dhe festimet ne qytetin tone filluan qe me 2 Mars dhe u vijua gjate gjith vitit.

d-Mirembajtja e varrezave publike dhe te deshmoreve

Me financim nga fondet e Bashkise u be e mundur qe te sigurohet nje siperfaqe toke truall reth 1000m2 per varrezat publike e cila u sistemua dhe ju bashkangjit varrezave egzistuese . Me kete siperfaqe eshte bere te mundur qe te perballohen nevojat edhe per nje periudhe kohe rreth 3-4 vjecare .

II- Sektori veterinare dhe mbrojtjes se konsumatorit :

Specialistet te Sektorit veterinare kan ushtruar kontroll cdo dite ne te gjitha pikat ku tregtohen produkte me origjine shtazore ne menyre qe ky aktivitet te kryhet konforme te gjith rregullave higjieno- sanitare dhe keto subjekte te pajisen me gjith dokumentacionin e duhur.

Ne pergjithesi bizneset qe tregtojne mish e zhvillojne aktivitetin e tyre duke qene te paisur me dokumentacionin perkates ashtu sic e kerkon ligji .Fale punes se ketij sektori por edhe bashkepunimit me policine Bashkiake dhe institucionet si AKU, DSHP etj nje permiresim te ndjeshem ka patur edhe ne tregtimin e peshkut.

III- Sektori i sherbimeve:

Puna e sektorit te sherbimeve publike ka qene ne funksion te mirembajtjes se infrastruktures ne pergjithesi, krahas punes se bere ne objektet shkollore te qytetit dhe ne objektet e institucioneve vares te Bashkise .

E rendesishme eshte te theksoj se jane kryer te gjitha sherbimet e parashikuara ne objektet shkollore te qytetit ne kohen e duhur, duke bere te mundur qe ne cdo shkolle te qytetit te kete kushte normale per zhvillimin e procesit mesimor .

Krahasuar me nje vit me pare, baza materiale ne dispozicion te objekteve shkollore ka qene me e vogel per shkak te mundesive financiare te Bashkise pamvaresisht nevojave ne keto objekte .

Gjithashtu eshte nderhyre me riparime e rikonstruksione pothuajse ne te gjitha objektet e institucioneve ne varesi te bashkise si pallati I kultures , biblioteka e qytetit , qendra emoshes se trete ,etj ku sherbimet jane kryer ne kohe nga ana jone .

Nje vemendje te vecante i eshte kushtuar mirembajtjes se sistemit te ndricimit ne te gjitha rruget ,sheshet dhe lulishtet e qytetit. Nga ana jone eshte punuar qe krahas mirembajtjes se vazhdueshme te rrugeve me infrastructure te pershtateshme te futen element te ri persa i perket

sinjalistikes rrugore , vizimit te rrugeve , vendparkimit te mjeteve dhe gjithë elementet tjere qe kane te bejne me kete problem ..

IV- Sektori i mjedisit strehimit dhe emergjencave civile .

Megjithë punen e vazhdueshme qe eshte bere per te patur nje mjedis te paster dhe te shendetshem mund te them qe kemi akoma shume pune per te bere per te arritur objektivat tona .

Gjate kesaj periudhe eshte punuar me gjithë aktoret per permiresimin e situates mjedisore :

- a) Jane marre te gjitha masat per parandalimin e levizjes se kafsheve ne hapsirat publike te qytetit .
- b). Eshte bashkepunuar me policine Bashkiake ne te gjitha rastet kur jane shfaqur probleme me ndotjen e mjedisit .
- c)Eshte punuar ne drejtimim te sensibilizimit te opinjonit qytetar per mbajtjen paster te mjedisit nga inertet ,ndalimin e levizjes se lafsheve nga hapësirat publike te qytetit si dhe evitimin e cdo lloj ndotje.

DREJTORIA JURIDIKE & PROKURIMEVE PUBLIKE :

Ka patur si detyre :

1. Të ndikojë ne zbatimin e ligjshmerise ne veprimtarinë e Këshillit të Bashkiak, komisioneve te tij, të Kryetarit të Bashkisë dhe administratës, nepërmjet asistencës juridike;
2. Kontrollin e bazueshmërisë ligjore te aktet administrative (urdhra, vendime, urdhëresa) që i paraqiten Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë;
3. Te përfaqësojë institucionin e Bashkise, në proceset gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit, kur jemi te paditur ose pale e interesuar;
4. Realizimin e prokurimeve publike, mirembajtjen e dokumentacionit dhe lidhjen e kontratave me sipermarresit.

Si jane realizuar detyrat e ketij sektori :

a. Ne sektorin Juridik :

- Ne harkun kohor te 12 muajve te vitit 2012, nga kjo drejtori jane ndjekur 20 çeshtje gjyqesore nga te cilat 14 me objek pronesie dhe 6 per çeshtje administrative.
- Sektori Juridik gjate vitit 2012 ka asistuar 135 akte administrative te konfirmuara nga Kryetari i Bashkise dhe 100 akte te miratuara nga Keshilli Bashkiak.
- Jane zbatuar te gjitha afatet ligjore ne hartimin dhe publikimin e regjistrit te prokurimeve publike per vitin 2012;
- Nga sektori i Prokurimeve Publike jane zhvilluar 13 tendera per mallra, sherbiem dhe investime publike;
- Eshte punuar ne bashkëpunim me USAID, Co Plan e me vone me ATRAKO-s, per zgjidhjen e problemeve te fizibilitetit te Parkut Industrial.
- Ne te gjitha rastet e nevojshme eshte dhene konsulenca juridike drejtorive, si për njohjen e legjislacionit dhe interpretimin e ligjit per rastet konkrete.
- Eshte bashkepunuar me Drejtorine e Burimeve Njerezore, per hartimin e kerkesave per kualifikim ne testimin e organizuar, per pranimin ne sherbimin civil etj.

Disa probleme te evidentuara ne kete drejtori:

5. Jo gjithnje jane mbrojtur me kompetence ligjore çeshtjet qe kane patur objekt padie bashkine, praktikat e saj administrative dhe çeshtjet e pronesise, kur ne kemi qene pale e interesuar.
6. Nuk ka patur bashkerendim ndermjet drejtorive, per te sqaruar problematiken qe eshte trajtuar ne gjykate;
7. Ne praktiken e prokurimeve publike, jane konstatuar mjaft mangesi ne plotesimin ne kohe dhe administrimin e dokumentacionit ligjor.

DREJTORIA E PROGRAMIM ZHVILLIMIT :

Ka patur si objektiv te vitit 2012:

1. Evidentimin dhe perpunimin e indikatorëve të zhvillimit social-ekonomik mbështetur në Strategjinë e zhvillimit miratuar në vitin 2005;
2. Permiresimin e strategjise së zhvillimit afat shkurtër e afatmesëm për territorin e qytetit, për vitet 2012 - 2015 në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit;
3. Hartimin e “Strategjise së zhvillimit të Turizmit” në qytetin e Lezhës;
4. Bashkëpunimin me donator vendasë e të huaja, fondacione dhe shoqata, të cilat shprehin interes, për të bashkëpunuar ose investuar në territorin e Bashkisë;
5. Përgatitja dhe afishimi i materialeve promovionale, në të cilat pasqyrohet puna dhe aktiviteti gjithëvjetor i Bashkisë;
6. Azhurnimi i faqes së internetit dhe mirëmbajtja e logjistikes elektronike të aparatit etj.

Ndër realizimet e vitit 2012 nga kjo drejtori evidentojme :

- a. Hartimi i Strategjise së Zhvillimit afat shkurtër e afatmesëm e afatgjatë në territorin e qytetit, në harmoni me strategjitë rajonale, kombëtare me standarde Europiane.
- b. Të monitorojë realizimin e detyrave për implementimin e planeve dhe strategjive të zhvillimit.
- c. Të përpilojë dhe hartojë indikatorët e zhvillimit të territorit duke grumbulluar të dhënat e nevojshme, dhe mbi bazën e tyre, në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë e tjera dhe institucionet vartëse, nën përgjithësimet e nevojshme dhe përcaktohen drejtimet dhe prioritetet e zhvillimit.
- d. Të ndjekë ceshtjet e infrastruktures në territor duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Urbanistikës, me Drejtorinë Juridike dhe të Prokurimeve Publike etj.

Drejtimet baze kanë qenë;

- A. Strategjia e Zhvillimit
- B. Statistika
- C. Botimi i Buletinit Informativ, periodik
- D. Azhurnimi i Faqes Zyrtare të Bashkisë Lezhë dhe FB
- E. Botimi i Profilit Ekonomik të Lezhës, etj.

1.Strategjia e Zhvillimit:

- Finalizuar Vizionin, qëllimet dhe objektivat e Strategjise së Zhvillimit.
- Aprovuar në KB Këshilli Partneritetit për Strategjinë e Zhvillimit të Qendrushëm Ekonomik

Zhvillimi Ekonomik:

Projekte për permiresimin e Infrastruktures dhe gjetje donatorësh të mundshëm kanë qenë fokus të punës për vitin 2012:

Zhvillimi Kulturor:

- Implementim i suksesshëm i projektit të IPAS për Turizmin: Tabela Treguese; Broshura; Fletëpalosje informative turistike; analize ofertet turistike; hartesh turistike

Zhvillimi Social:

- Permiresim politikash shoqëruar dhe me projekte konkrete.
- Integrimi gjinor në politikat e zhvillimit është në progres. Është ngritur struktura ligjore dhe po punohet për planin e veprimtimit
- Praktika me të Mirë për Integrimin e Romëve është një projekt që po permireson punën e bashkisë me komunitetin Rom dhe Egjiptian

Kjo drejtori ka plotësuar sipas kërkesave të donatorëve këto projekt propozime :

1. Ndertimi i Murit Rrethues dhe sistemime në oborrin e kompleksit të shkollave në lagjen “Beselidhja”
2. Integrimi Gjinor në politikat e Zhvillimit në Bashkinë Lezhë_UNDP

3. Ne kuader te projektit “Praktika me te mira per integrimin e Romeve-OSBE-ODHIR eshte shkruar projekti per grantin:Investime ne Lagjen ku banojne romet. Specialiste e Informacionit ka punuar per te mirembajtur aparaturat elektronike, instalime programe, asistence teknike te ndryshme. Krahas sa siper nga ana e Drejtorise se Programim Zhvillimit ka punuar per pergatitjen e botimeve te ndryshme qe pasqyrojne punen dhe aktivitetin e bashkise dhe rrisin informacinin per komunitetin:

Cfare mund te kishim bere me mire;

- 1.Duhet te punojme per te gjetur strategji pune me te mira per rritjen e pjesemarrjes se komunitet ne politike berjen e Bashkise Lezhe.
- 2.Niveli i raportimit te punes per secilen drejtori per tu promovuar elektronikisht,media vizuale ose e shkruar eshte per tu permiresuar ne 2013
- 3.Lidhja me donatoret potenciale duhet permiresuar per tu shtuar resurset financiare.
- 4.Stastika mbetet nje problem per tu konsideruar me mire,pasi informacioni i mbledhur nuk mundeson pergatitje materiali statiskor per botim serioz ne nivelin e Baskise Lezhe.

DREJTORIA E ARSIMIT, TURIZMIT, KULTURES & SPORTEVE

Ka patur si objektiv :

1. Të sigurojë raporte partneriteti dhe marrëdhënie efektive me gjithë faktorët bashkëpunues per krijimin e kushteve optimale, ne zhvillimin e procesit mesimor, si nje faktor kryesor për ngritjen e cilësisë në sektorin e arsimit;
2. Ngritjen ne nivele bashkëkohore te veprimtrive kulturor e sportive dhe bashkëpunimi me grupet e interesit, komunitetin e biznesit, fondacione, OJF dhe stafet perkatese te ketyre sektoreve, në funksion të rritjes se cilësisë dhe implementimit të projekteve të zhvillimit ne keto sektorë;
3. Koordinimin e punës me institucione shkencore dhe subjekteve te interesuara, per nje pune shkencore permanente ne evidentimin dhe propogandimin e vlerave historike e arkeologjike të zbuluara dhe qe do zbulohen ne te ardhmen, per qytetin antic te Lis-it.

Viti per te cilin ne bejme analizen ishte nje vit jubilar i 100 vjetorit te Pavaresise.

Duke qene i tille, ne qe kur vendosem objektivat ne fillim te vitit morem mire parasysh ngarkesen qe do te kishim dhe caktuam nje sere aktivitetesh te permasave te ndryshme per te mundesuar krijimin e nje klime kulturore- artistike ndryshe ne qytet, ashtu siç i takonte ketij viti te madh per te gjithë shqiptaret.

Te gjithë sektoret e drejtorise tone kane punuar si nje trup i vetem per realizimin e objektiveve te vena ne menyren me te mire te mundshme, por bashkepunimi ka qene maksimal edhe me te gjitha drejtorite e tjera te Bashkise, me Ministrine e Kultures, me D.A.R. me Qendren Kulturore te femijeve, me shkollat publike dhe private, me Shoqatat , Ambasadat ,me Ipa Adriatik, me medjat lokale dhe kombetare me ekipet e sporteve etj.

Ne pallatin e kultures jane zhvilluar 47 aktivitete kulturore-artistike, jane rritur te ardhurat nga sallat e leshuara me qera, eshte bere inventari bazes material, per cilesine e aktiviteteve eshte bashkepunuar me bordin e kultures. Eshte punuar shum me talentet nga stafi i P.te Kultures Eshte rritur cilesisa e sherbimit ndaj turisteve tek Memorjali dhe eshte rritur vlere e te ardhurave nga shitja e biletave ne krahasim me vitin 2010

Objektet shkollore kane qene vazhdimisht ne qendren tone te vemendjes per krijimin e kushteve sa me normale per mesimdhenjen, si dhe sherbimi ne konvikt ka qene ne lartesine e kerkuar Infrastruktura shkollore ka pesuar ndryshime te jashtezakonshme si ne ambientet e brendshme ashtu dhe ne ato te jashtme

Interesimi per kopshtet dhe cerdhen ka qene maksimal per plotesimin e kushteve dhe sigurimin e ngrohjes.

Kemi bashkepunuar vazhdimisht me shoqatat per ngritjen e cilesise se jetes kulturore –artistike ne qytet

Me ekipet e sporteve kemi patur nje bashkepunim te vazhdueshem dhe kur kane patur rezultate te larta kane marre dhe shperblime

Kemi bere projekte per turizmin dhe kulturen ne bashkepunim me EUFT Tirane dhe jemi ne pritje te pergjigjes pozitive nga BE

Kemi bere si staf trajnime te ndryshme per rritjen profesionale, per barazine gjinore per

DREJTORIA BURIMEVE NJEREZORE:

Ka synuar :

1. Ne plotesimin e kerkesave baze te punonjesve te aparatit te Bashkise dhe institucioneve vartese, per te mundesuar veprimtarine normale te punes.
2. Ofrimin e punës së administratës së bashkisë me legjislacionin, politikat lokale e rajonale dhe zbatimin e vendimeve të kryetarit dhe Këshillit të Bashkisë ne veprimtarine e çdo punonjesi.
3. Nepermes sektorit te maredhenjeve me publikun, eshte punuar per evidentimin e problemeve te ngritura nga komuniteti dhe venja ne rrugen e zgjidhjes te kerkesave dhe ankesave subjektive te ngritura nga qytetaret;
4. Prezantimin ne media lokale dhe kombetare te arritjeve dhe problemeve qe jane evidentuar ne punen e Bashkise , insitucionet e tjera publike, ne interes te komunitetit lezhjan.

Disa nga realizimet e kesaj drejtorie evidentojme :

- Plotesimin e strukturess e personelit dhe nevojat themelore, per mbarëvajtjen e punes se çdo drejtorie .
- Zbatimin e kerkesave te Komisionit Sherbimit Civil dhe vendimin e Keshillit Bashkise, per organizimin e konkursit, per pranimin ne sherbimin civil te administrates se bashkise;
- Kualifikimi i punonjesve te administrates nepermes formave te ndryshme, perfshire bashkepunimin me institucione te specializuara si; Instituti i trajnimeve te Administrates Publike (ITAP), USAID; GTZ; dldp (Intercooperation) etj.,
- Informimin media-tik, nga televizioni publik jane dhene 246 kronika komente dhe biseda direkte, per problematiken e qytetit, pa llogaritur ata lokal.
- Administrimi dhe sistemimi i dokumentacionit arkivor dhe dorezimi i tij sipas etapave ne arkivin e qarkut.
- Nga sektori i maredhenjeve me publikun jane organizuar pritje ditore dhe periodike, per problemet te ndryshme si, per strehim, punesim, ndihme ekonomike, sherbime publike etj. Nga te dhenat e meposhtme rezulton te jete shenuar nje rritje ne numrin e kerkesave dhe ankesave nga banoret ne raport me nje vit me pare.

Konkretisht kemi kete pasqyre te regjistruar per vitin 2012 :

<i>Viti</i>	<i>Kerkesa :</i>	<i>Ankesa</i>	<i>Vertetime</i>
2010	461	333	2 250
2011	840	240	3175
2012	100	-	2775

- Nga sektori i protokollit jane menazhuar **2570 shkresa** ne hyrje dhe **1920 shkresa** te prodhuara nga administrata, sipas tabelës :

<i>Vitet</i>	<i>Shkresa</i>		<i>Vendime/ Kryetarit</i>	<i>Urdhera/ kryetarit</i>
	<i>Hyrje</i>	<i>Dalje</i>		

2010	1224	1387	77	56
2011	2786	1879	64	71
2012	2570	1920	57	63

Si konkluzion: Rritja e korespondences zyrtare ne hyrje – dalje, kerkesave, ankesave dhe vertetimeve te ndryshme, mund te vleresohet si nje volum me te madh pune gjate vitit 2012, ndaj nje viti me pare, ka patur nivele te ngjashme me vitin 2011, persa i takon aktivitetit shkresor..

Disa probleme qe duhen evidentuar :

Se pari : Me gjithë ndryshimet e realizuara gjate vitit 2012, ndones u be testimi dhe marrja me konkurim ne vitin 2011, akoma nuk kemi krijuar modeli i kerkuar i nje nepunesi profesionist dhe intelektual.

Se dyti : Edhe nje vit me pare e kemi theksuar faktin se; tek ndonje individ i veçante mungon vullneti per punen dhe detyrimin ndaj taksapaguesit lezhjan.

Ndaj ketyre problemeve duke e marre ne formen e verejtjes ne kete analize, kerkojme te jete me aktive dhe me kerkuese vete drejtoria e Burimeve Njerëzore, si promotor i mbarevajtjes se punes ne administrate.

INSPEKTORIATI NDERTIMOR URBANISTIK

Kjo strukture e cila vepron brënda territorit te Bashkise ka patur si mision ushtrimin e përgjegjësi në kontrollin dhe zbatimin e standarteve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës ne zbatim te ligjit “Për Inspektimin e Ndërtimit” dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij.

Kjo strukturë e Bashkisë ka patur si objekt pune për vitin 2012:

-Mbajtjen nën kontroll të gjithë territorit urban të Bashkisë, në funksion të zbatimit të planit rregullues të qytetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit 2012 nga ana e INU Bashkisë është punuar me ndjenjë përgjegjësie e preokupacion të lartë për realizimin e detyrave. Për këtë nga ana e INU-s është ndjekur në vijimësi:

- Ndërtimet me leje ne territorin qe ka ne administrim Bashkia Lezhe.
- Verifikimin e dokumentacionit tekniko – ligjor dhe zbatimin e kondicioneve urbane te sheshit dhe lejes ndertimit, për objektet në ndertim.
- Ndërtimet pa leje në territorin që ka në administrim Bashkia Lezhe.
- Pezullimin e menjëhershëm të objekteve që fillojnë ndërtimin pa dokumenta tekniko=ligjor, ose ato jashtë kondicioneve urbane që janë me leje ndërtimi.
- Kontrolli i ngritjes së kantjerit dhe plan-organizimit të punimeve.
- Kontrolli i marrjes e zbatimit të masave të sigurimit teknik.

Si rezultat i punës së bërë gjatë vitit 2012 evidentojme:

-Janë kryer 79 Proces Verbale konstatimi për ligjshmërin e ndërtimit, janë bërë 61 Vendime Prishje, janë bërë 57 Proces Verbale Ekzekutimi dhe janë në proces Ekzekutimi rreth 6 Vendime. Janë bërë 11 Vendime për pezullimin e punimeve të ndërtimit, 4 Vendime për plotësimin e dokumentacionit teknik dhe ligjor si dhe janë vendosur 4 Gjoha për kundërvajtje administrative. Që do të thotë se është ndërhyr për prishjen e rreth 60 objekteve kryesisht pa dokumente tekniko-ligjore dhe disa raste është ndërhyrë në objektet me dokumente të ligjshme, vetem në ato raste ku është investuar në infrastruktur.

-Jane evidentuar objektet e ndertuara pa leje ne territorin e Bashkise, me prioritet ndertimet ne Zonen e Parkut Arkeologjik dhe në bashkpunim me Zyren e Menaxhimit të Parkut Arkeologjik Lezhë është ndërhyrë në tre raste për lirimin e hapsirave dhe objekteve të zëna nga subjekte të ndryshme.

-Eshhtë bërë evidentimi, pezullimi i menjehershëm i punimeve në objektet që janë konstatuar si ndertime pa dokumentacion teknik – ligjor.

Per të shmangur ndertimet me dhe pa leje në Zonen e Parkut Arkeologjik janë marrë keto masa :

1. Eshtë punuar për sensibilizimin e opinionit publik, për të ruajtur vlerat arkeologjike e kulturore të qytetit tone si një shans historik që i është dhënë Lezhës.

2. Nga Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik është mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm zona në fjalë, për të parandaluar dhe mos lejuar ndertime me leje ose pa leje në zonen e Parkut Arkeologjik.

3. Ndertimet e derisotme në bashkëpunim me Zyren e Menaxhimit të Parkut Arkeologjik Lezhë janë bërë prezent MTKR&S dhe INUK, për të bashkërenduar punën për pastrimin e saj nga ndertimet.

Me gjithë punën e bërë, çdo ditë, vihen re se, nga subjektet të ndryshëm juridike apo fizike ka tendenca për shkelje apo mos respektim të kushteve urbane në ndertime si në zonen urbane dhe në zonen arkeologjike apo shkelje të afateve kohore të lejes së ndërtimit e kondicioneve në ndërtim.

POLICIA BASHKIAKE

Në përberje të se ciles janë 7 veta me një mision të rëndësishëm në Bashki, si institucion i zbatimit të akteve administrative dhe mbështetje në të gjithë praktikën ligjore, të sektoreve të tjera. Nder detyrat kryesore të realizuara nga Policisë Bashkiake kanë qenë :

- Kryerja e shërbimeve në funksion të ruajtjes së rendit, qetesisë dhe mbarevajtjes së jetës në qytet;
- Zbatimin e akteve të nxjerra nga Kryetari dhe Këshilli i Bashkisë, kur ata kanë të bëjnë me rendin, qetesinë, sigurimin të ardhurave vendore, lirin e mjedisve publike etj.
- Kërkesa e vazhdueshme, për respektimin e dispozitave ligjore, të cilat rregullojnë veprimtarinë e shitblerjeve në mjediset publike dhe respektimin e rregullave të tregut etj.
- Parandalimin e ndotjeve të mjedisit nga subjekte private apo publike dhe marrjen e masave për vendosjen e situatave normale në qytet;

Krahas këtyre detyrave një vend të rëndësishëm në punën e Policisë Bashkiake ka zënë mbështetja ndaj drejtorisë Tatim Taksave, për realizimin e të ardhurave vendore dhe Inspektoriatit Ndërtimor, për pezullimin e ndertimeve të paligjshme dhe shembjen e objekteve paleje, për t'i hapur rrugë investimeve publike.

Një vend të rëndësishëm ka zënë kontrolli i perditetshëm, gjëritja dhe largimi i makinave të parkuara në kundërshtim me rregullat e “Kodit Rrugor”, për disiplinimin e trafikut, ndonëse kompetencat e cinguarat të policisë bashkiake në këtë drejtim.

Por krahas angazhimeve janë verejtur edhe vështiresi në kryerjen e detyrës ndër të cilat evidentome :

1. Mangësi i ligjit, për kompetencat e policisë bashkiake në qytete si Lezhë, kryesisht në aspektin e qarkullimit dhe mungesa e bashkëpunimit me sektorin e policisë së qarkullimit rrugor.
2. Mangësi në bashkërendimin me strukturat e tjera të Bashkisë, në mbështetje të kërkesave për zbatimin e akteve administrative dhe detyrimeve ligjore.
3. Mungesa e bashkëpunimit me strukturat e policisë së rendit, kryesisht me ato të qarkullimit rrugor;
4. Disiplina e punës dhe kultura gjatë kryerjes së shërbimit nuk ka qenë gjithnjë në lartësi dhe duhur, me norma qytetarie dhe kodin e etikës së policit.

Keto kanë qenë disa mangësi dhe vështiresi me të cilat është përballur puna e Policisë Bashkiake. E rëndësishme mbetet, jo vetëm evidentimi i tyre, por reflektimi ndaj mangësive të konstatuara dhe përmirësimi i punës në vitin 2012.

ZYRA E GJENDJES CIVILE:

Si funksion i deleguar me nje staf prej dy vetash ka patur si mision :

1. Te realizoje nje sherbim te shpejte dhe te kulturuar ndaj qytetareve, per te krijuar nje performance te mire ne komunitetin lezhjan.
2. Per te qene aktiv ne zbatim te kerkesave te reja ligjore, per kompjuterizimin e sherbimit te Gjendjes Civile dhe perditesimin e Rregjistrimit Kombetar te Gjendjes Civile.
3. Zbatimin e kerkesave te ligjit, per saktesine e listave zgjedhore ne zgjedhjet vendore te 8 majit 2012 dhe perballimi i fushates me te gjitha elementet e saj .
4. Bashkëpunimi me zyrat homologe te njesive vendore, me instrucionet e tjera te rrethit dhe kompanine e prodhimit te pasaportave Biometrike etj.

Nder arritjet e vitit evidentojme :

- Si prioritet i kesaj zyra ka qene pergjegjesia ndaj ligjit ne hartimin e listave zgjedhore dhe korektesia ndaj kerkesave te forcave politike, ne te gjitha etapat zgjedhore.
 - Perditesimi me korektesi i Rregjistrimit Kombetar te zgjedhjeve, per te menjanuar çdo pretendim te forcave politike ne fazen parazgjedhore.
 - Krijimin e kushteve te punes dhe implemtimi i projektit, per leternjoftimet e reja dhe pasaportat Biometrike.

Ndersa si proiritet te Gjendjes Civile per vitin 2013 evidentojme :

- a. Persosjen e sherbimit ndaj qytetareve dhe;
- c. Vendosja e sistemit te adresave ne bashkepunim me Drejtorine e Urbanistikes se Bashkise dhe Drejtorine Rajonale te Postave.

Objektivi me madhor, per vitin 2013 eshte "Rritja e cilesise se sherbimit ndaj qytetareve" e cila do te mundesohet nepermes ketyre rrugeve :

1. Rritjes se cilesise se sherbimeve publike;

Te nderuar pjesëmarrës !

Me arritjet e deritanishme dhe sigurine per pune akoma me te vyera ne vitin qe sapo kemi filluar, me angazhimin maksimal te burimeve njerezore dhe intelektuale, administrata e Bashkise, do krijojte premisa te besueshme, per.....

- Avancimin e vizionit tone ne lartesite e kerkesave te kohes, per te marre nisma te reja ambicioze, ne hartimin dhe implementimin e projekteve me rendesi zhvillimi per te ardhmen e qytetit;
- Per t'u vene gjithnje e me mire ne sherbim te komunitetit qytetar, ne funksion te rritjes se nivelit dhe cilesise se jetes tyre;
- Per te mundesuar hapisira te reja arsimimi dhe zhvillimi per brezin e ri;
- Per krijimin e mundesive per nje bashkejetese qytetare te te gjitha grup moshave, etnive dhe besimeve fetare si nje detyrim i perhershëm, ndaj qytetarise lezhjane.

Si perfundim :

Duke njohur me pergjegjesi mangesive tona te konstatuara gjate vitit 2011, do jemi me te vemendshem dhe kembengules ne permiresimin e metodologjise se punes dhe veprimtrise se gjithshme te administrates se bashkise per vitin 2012.

Faleminderit per vemendjen.

VIKTOR TUSHAJ

Kryetari i Bashkise

Lezhe, me 28.01.2012